

**Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit**

Nr.07/351-49533

Dt. 07.04.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së aplikuesit; **Kastriot (Mhill) Prenkaj nga Gjakova**, për dhënjen e Lejes së Ndërtimit për shëndrrimin e një pjese të kulmit në terrasë, në objektin ekzistues të banimit kolektiv, i cili posedon me Lejen mbi Legalizimin e ndryshimeve në gabarit dhe ngritjes së kateve – Aktvendimi Nr.07-351-4809, dt.15.12.2011, për etazhitetin B+P+6+K, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, Ligjit Nr. 04/L-134, për Ndërtesat e banimit në bashkëpronësi, Nenet 14,15,16 dhe 17, si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

## A K T V E N D I M

**I. I LEJOHET** aplikuesit: **Kastriot (Mhill) Prenkaj nga Gjakova**, pronar i regjistruar i njërive banesore – pjesë të ndërtesës, me nr. 3497-0-113-1-20-0, 3497-0-113-1-21-0, dhe 3497-0-80-0-20-0, ndërtimi - shëndrrimi i një pjese të Kulmit në terrasë, në objektin ekzistues të banimit kolektiv, sipas Projektit për ndryshim, në objektin ekzistues të banimit kolektiv, i cili posedon me Lejen mbi Legalizimin e ndryshimeve në gabarit dhe ngritjes së kateve – Aktvendimi Nr.07-351-4809, dt.15.12.2011, në emër të Gjon (Zef) Gjokaj, në njësinë kadastrale në ngastrën kadastrale me nr. 3497/0, ZK:Gjakovë – Qytet, në bashkëpronësi të Anton (Zef) Gjokaj dhe Sabina (Nrec) Gjokaj (me nga ½(pjesë ideale), për etazhitetin B+P+6+K, sipërfaqja e përgjithshme (bruto) për ndryshim  $S=65.60m^2$ .

**Terasa (sip. bruto)..... S = 65.60m<sup>2</sup>.**

**II.** Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi – shëndërrimi i një të kulmit në terrasë, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja projektuese “N.SH.N. KoronaING”.-Gjakovë.

**III.** Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

**VI.** Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

**IV.** Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

# Ar sy e t i m

**I. Kastriot (Mhill) Prenkaj nga Gjakova, me banim në rrugën “Mbretëresha Teutë, në cilësinë e pronar i regjistruar i njërive banesore – pjesë të ndërtesës, me nr. 3497-0-113-1-20-0, 3497-0-113-1-21-0, dhe 3497-0-80-0-20-0, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351-49533 të datës 05.12.2016 për dhënjën e Lejes së Ndërtimit për ndërtimi - shëndërimi i një pjese të Kulmit në terrasë, në objektin ekzistues të banimit kolektiv, sipas Projektit Kryesor për ndryshim, në objektin ekzistues të banimit kolektiv, i cili posedon me Lejen mbi Legalizimin e ndryshimeve në gabarit dhe ngritjes së kateve – Aktvendimi Nr.07-351-4809, dt.15.12.2011, në emër të Gjon (Zef) Gjokaj, në njësinë kadastrale në ngastrën kadastrale me nr. 3497/0, ZK:Gjakovë – Qytet, në bashkëpronësi të Anton (Zef) Gjokaj dhe Sabina (Nrec) Gjokaj (me nga ½(pjesë ideale), siq është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.**

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 19.09.2011, të punuar nga Byroja “Geogaus”-Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 17.01.2017 në pronësi të përbashkët të Anton (Zef) Gjokaj dhe Sabina (Nrec) Gjokaj, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikaten mbi të drejtën në pronën e paluajtshme me nr.të lëndës 5503/16, të datës 10.10.2016, në emër të Kastriot (Mhill) Prenkaj, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Çertifikaten mbi të drejtën në pronën e paluajtshme me nr.të lëndës 2274/16, të datës 17.01.2017, dhe me nr.të lëndës 2274/16, të datës 10.10.2016 në emër të Anton (Zef) Gjokaj dhe Sabina (Zef) Gjokaj, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
5. Aktvendimin mbi Legalizimin e ndryshimeve në gabarit dhe ngritjes së kateve – Aktvendimi Nr.07-351-4809, dt.15.12.2011, në emër të Gjon (Zef) Gjokaj të lëshuar nga DUMM.
6. Aktit Noterial – Autorizim me Nr.LRP.Nr.8146/2016, dt.20.09.2016.
7. Deklaratën Noteriale me nr.LRP.Nr.775/2017, dt.01.02.2017, nga pronartet e njërive të ndërtesës.
8. Projektin për ndryshim në 3 (tri) kopje, ndërmarrja projektuese N.SH.N.“KoronaING”.-Gjakovë.

**Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 335.30 Euro.**

## KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor në Prishtinë, dhe e njehta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.


### Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspektionit,
- Arhivës.

Zyrtar i lartë për çështje juridike

  
Zenel Shabani, jur. dipl.

U. D. Drejtori




  
Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark.

K.K. GJAKOVË

Zon. kadastrale : Gj.Qytet

Parcela nr. 1194,1196

# PLAN SITUACIONI



LOKACIONI I OBJEKTIT NE TE  
 CILIN ESHTË PEGAZUAR  
 ZGJERDUR I GJAZARITIT DHE  
 NERINDA KATIT 5,6+KULLI  
 I KATRETEZUESHËN

— Gjendja Faktike  
 — Gjendja Kadastrale

*Handwritten notes and signatures in the bottom right area.*

*Handwritten signature*

Kuvendi Komunës GJAKOVË  
Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë

# KOPJE PLANI

Zona kad.

GJAKOVË - QYTET


500

Shk. zvog. 1: 1000

Poseduesi:

1/2 GJOKAJ ANTON (ZEF)

1/2 GJOKAJ SASINA (VRECI)



Numri rendor i regjistrit të taksave kadastrale:

Nr. Parcelës	Plani	Vendi i quajtur	Kultura	Klasa	Sipërfaqja			Vërejtjet
					Ha	a	m <sup>2</sup>	
3597-0			P.kj. 0501		0	02	58	
					0	01	43	
Gjithësejtë					0	03	11	

Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastër duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.

17.07.2017

*Sh. Geni, gjy.*